



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.582/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj Kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani, dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për deputet Isak Shabani, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si i bazuar apeli i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Isak Shabani, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Vendvotimet 0402x-03R, 2113-01R, 2118B-02D, 2116B-02D, 2118B-01, 2102B-01R, dhe 2130B-01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

## A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 05.03.2021 në ora 08:58, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Isak Shabani, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në Vendvotimet: 0402x-03R, 2113-01R, 2118B-02D, 2116B-02D, 2118B-01, 2102B-01R, dhe 2130B-01R, janë bërë ndërhyrje/përmirësime gjatë regjistrimit të votave në Formularët e Rezultateve për Kandidat-FRK, dhe se iu janë evidentuar numër i vogël i votave në krahasim me votat e fituara siç pretendon apeluesi.

Parashtruesi i apelit si provë ka bashkangjitur kopje të Formularëve të Rezultateve për Kandidat-FRK dhe Formularëve të Përputhjes së Rezultateve-FPR.

Në apel kërkohet që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve në Kosovë, për shkak se sipas tij ka pasur abuzime të shumta dhe se abuzuesit e votave të marrin dënimin e merituar.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Isak Shabani, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në 0402x-03R, 2113-01R, 2118B-02D, 2116B-02D, 2118B-01, 2102B-01R, dhe 2130B-01R, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: “Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 582/202021 më datën 05.03.2021.

**Kryesuese e Panelit**  
**Kymete Kicaj**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.